



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 5, datë 18.10.2013

PËR


**MASAT EMERGJENTE TË NDËRHYRJES MBROJTËSE
DHE REHABILITUESE MJEDISORE NË ZONAT ME RËNDËSI
KOMBËTARE TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE HISTORIKE**

Në mbështetje të nenit 6, 8, nenit 32, të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e atyre zonave ku do të ndërmerren masa të natyrës emergjente me qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin mjedisor të zonave me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike, sipas listës së inventarit të Ministrisë së Kulturës dhe hartave ilustruese në funksion të listës.
2. Pezullimin e dhënies së të gjitha llojeve të lejes zhvillimore në këto zona, nga autoritetet e planifikimit, deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.
3. Deri në miratimin e e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, autoritetet e planifikimit lejohen të japid leje zhvillimore në këto zona, vetëm për këto raste përjashtimore:
 - a) Punime mirëmbajtjeje;
 - b) Leje zhvillimore për interes publik, shtetëror dhe kombëtar.

4. Ministria e Kulturës të bëjë evidetimin dhe përditësimin e të dhënave për monumentet e kulturës, zonat muze, ansambël muze, ansambël monument kulture, qendra historike dhe parqet arkeologjike si dhe të përcaktojë rregullat që kanë ndikim në planifikimin e territorit për secilën kategori.
5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Kulturës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale dhe Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, për marrjen e masave emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në këto zona.
6. Ngarkohen autoritetet e planifikimit për ndjekjen dhe zbatimin e pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



ZËVENDËS KRYETARE E K.K.T

EGLANTINA GJERMENI
MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA
DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

